



# Koronavirusi: Informacion mbi vaksinimin në kantonin Zürich

Gjendja më datën 09.04.2021

## Vaksinimi është vullnetar dhe falas.

### A mund të vaksinohem unë?

Ju mund të vaksinoheni nëse

- > jeni mbi 16 vjeç
- > nuk keni temperaturë ose ndonjë simptomë tjetër të COVID-19
- > nuk jeni alergjike/alergjik ndaj asnjë përbërësi të vaksinës (PEG)
- > nuk jeni në izolim ose në karantinë
- > Gratë shtatzëna, nënat gjidhënëse, personat alergjikë me reagime të rënda në të kaluarën dhe personat me imunosupresion të rëndë duhet të kërkojnë mendimin e mjekes ose mjekut të tyre, që të mund të vaksinohen.

### A mund të regjistrohem tani për vaksinimin?

Të gjithë personat e moshës 16 vjeç e lart, që dëshirojnë të vaksinohen, mund të regjistrohen për vaksinimin Covid-19. Tani për momentin mund të rezervojnë një takim për vaksinimin vetëm personat 65 vjeç e lart dhe personat me sëmundje kronike. Nëse vuani nga një sëmundje kronike, ju lutemi kontaktoni mjeken ose mjekun tuaj. Për t'u vaksinuar në një qendër vaksinimi ju duhet një certifikatë mjekësore.

### Si mund të veprojmë?

Regji-strohuni dhe lajmëroni në:  
[www.zh.ch/coronaimpfung](http://www.zh.ch/coronaimpfung).  
Nëse keni nevojë për ndihmë:  
0848 33 66 11

**Për lajmërim unë duhet të kem në dispozicion të dhënat e mia në vijim:** të dhënat personale, emri dhe numri i Sigurimit shëndetësor.

### Ku mund të vaksinohem?

Vetëm me prenotimin e mëparshëm të një takimi:



#### Në qendrat për vaksinim

**Affoltern am Albis** Holiday Inn Express, Obstgartenstrasse 7

**Bülach** Stadthalle, Allmendstrasse 8

**Dietikon** Stadthalle, Fondlistrasse 15

**Horgen** Seehallen, Seestrasse 87

**Meilen** Turnhalle Dorfprovisorium (DOP), Schulhausstrasse 23

**Uster** Sportareal Buchholz, Hallenbadweg 4

**Wetzikon** Kunsteisbahn, Rapperswilerstrasse 63

**Winterthur** Rieter-Areal Töss, Klosterstrasse 22

#### Zürich

Messe Zürich, Wallisellenstrasse 49

Referenz-Impfzentrum der Universität Zürich, Hirschengraben 84

Stadtspital Triemli, Birmensdorferstrasse 497



#### Në qendrat mjekësore

Personat me sëmundje kronike rekomandohen, që të vaksinohen në një qendër mjekësore.



#### Në farmaci

Vaksinimi në farmaci do të jetë i mundur prej majit.